

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 333 Prot.

Tiranë, më 15.03 2017

VENDIM Nr. 35, datë 13.03.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 4, jashtë radhe, të datës 13.03.2017, pasi shqyrtoi Informacionin mbi verifikimin në terren, në kuadër të projektit "*Rikualifikimi Urban i Pazarit të Tiranës, Markatës së Mish-Peshkut, Fruta-Perimeve dhe sheshit "Avni Rustemi"*"-subjekti Bashkia Tiranë, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik (ASHA) dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK).

VENDOSI:

1. Të miratojë Informacionin mbi verifikimin në terren, në kuadër të projektit "*Rikualifikimi Urban i Pazarit të Tiranës, Markatës së Mish-Peshkut, Fruta-Perimeve dhe sheshit "Avni Rustemi"*"-subjekti Bashkia Tiranë, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik (ASHA) dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK).
2. Të ruhet *in situ*, *Struktura-Shtrojë dekorative në formë kalldrëmi*, e zbuluar gjatë punimeve të zbatimit të projektit të sipërpërmendur, duke marrë masat e nevojshme mbrojtëse, për ruajtjen e saj, deri në një vendimmarrje përfundimtare, për një zgjidhje teknike të qëndrueshme, në lidhje me të.
3. Të kryhet nga Investitori rilevimi i plotë i strukturës së zbuluar dhe zonës përreth, i cili do të shërbejë në vijim, për përcaktimin e një zgjidhje teknike të qëndrueshme dhe përfundimtare, në lidhje me evidentimin dhe integrimin e saj, në këtë zonë.
4. Projekti i zgjidhjes teknike të qëndrueshme dhe përfundimtare, të kalojë për shqyrtim dhe vendimmarrje në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve dhe Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO EURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO